



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

KODI I ETIKËS PROFESIONALE

Prishtinë, 17 qershor 2011



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, sipas autoritetit të dhënë me Nenin 8 paragrafi 1, nënparagrafin 1.6, Nenin 10 dhe Nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185, në seancën e mbajtur me datë 17.06. 2011 miratoi:

KODIN E ETIKËS PROFESIONALE

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Kodi është që të përcaktojë parimet themelore të etikës dhe rregullat e sjelljes së Anëtarëvetë Bordit dhe personelit të i ZRRE-së.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kodi i Etikës Profesionale përcakton rregullat që vlejné për anëtarët e Bordit dhe personelin e ZRRE-së, për të siguruar se punët kryhen me përgjegjësi dhe ndërshtëmëri, duke iu shmangur konfliktit të interesit, si dhe për të siguruar pajtueshtëmëri të vazhdueshme me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
2. Ky Kod do të nxitë cilësinë e shërbimeve për palët, etikën në punë dhe interesin publik, duke u karakterizuar nga integriteti, ndershtëmëria, objektiviteti dhe paanshtëmëria në përmbushjen e detyrave.
3. Mosnjohja e Statutit dhe Kodit të Etikës profesionale të ZRRE-së, nuk i arsyeton anëtarët e Bordit dhe personelin e ZRRE-së, për çfardo shkelje të dispozitave të këtij kodi.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë kod kanë këtë kuptim:
 - 1.1 **“Bordi”** – Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji.
 - 1.2 **“Informatë konfidenciale”** të dhëna, dokumente apo informacione tjera, komerciale apo teknike, që kanë të bëjnë me dizajnin, reabilitimin, sigurinë, veprimin, mirëmbajtjen dhe financimin e operimeve apo aktiviteteve që nuk janë më në domenin publik dhe zbulimi i të cilave mund të vejë në rrezik interesat komerciale të aplikantëve dhe/apo të të licencuarve.
 - 1.3 **“Konflikt i Interesit”** –konfliktin e interesit publik dhe interesit privat të një zyrtari kur gjatë ushtrimit të një funksioni të tij, zyrtari ose personi i afërt ka interes privat pasuror ose përfitim personal jo pasuror të drejtëpërdrejt ose të tërthortë, që ndikon ose mund të



ndikojë në kryerjen në mënyrë të drejtë të funksionit publik që ai ushtron. Në asnjë rrethanë nuk mund të shfrytëzohet pozita për përfitim direkt apo indirekt.

1.4 “ZRRE” –Zyra e Rregullatorit për Energji.

2. Termat e përdorur në këtë kod, kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Ngrohjen Qendrore, Ligjin për Gazin Natyror dhe Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Neni 4

Përgjegjësitë e Personelit

1. Anëtarët e personelit do të jenë përgjegjës për sjellje të mirëfilltë etike dhe ligjore përmes përkushtimit të demonstruar në përmbushjen e detyrave të punës sipas dispozitave të këtij Kodi dhe të gjitha kërkesave ligjore dhe rregullative që janë relevante për ZRRE-në.
2. Anëtarët e personelit të ZRRE-së, duhet të zbatojnë standardet më të larta të etikës me qëllim të shmangies së interesave personale që mund të shkaktoj vënien në pozitë të vështirë të vetëvetes dhe personelin e zyrës dhe të mos lejojë që interesat e tij private të bien ndesh me pozitën e tij zyrtare.
3. Për përmbushjen e përgjegjësive së tij, anëtari i personelit do të:
 - 3.1. respektoj këtë Kod dhe të gjitha ligjet dhe rregulloret të aplikueshme që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e tij për punë;
 - 3.2. Mbajë pozitë të paanshme dhe objektive ndaj të gjitha palëve (ndërmarrjeve të licencuara, konsumatorëve, konsulentëve ose ndonjë pale të tretë, etj), dhe në rast të shkeljes së dispozitave të këtij Kodi ta raportoj një sjellje të tillë;
 - 3.3 Mbaje pozitë të paanshme për punëtorët e personelit që janë përfshirë në sjellje të pandershme, gjatë orarit të punës.
4. ZRRE -ja do të sigurojë mundësi të barabarta në të gjitha aspektet e punësimit dhe nuk do të toleroj asnjë lloj diskriminimi apo keqtrajtimi brenda ZRRE-së si: gjinore, racore, etnike, etj.
5. Nëse cilido anëtar i personelit beson që është viktimë e një diskriminimi ose keqtrajtimi, ngacmim psikik ose verbal, ai duhet ta raportojë këtë menjëherë tek mbikëqyrësi. Mbikëqyrësi do të raportoj çështjen te Bordi. Nëse mbikëqyrësi heziton ta bëjë këtë, viktimë mund ta informoi te Bordin.
6. Nëse konstatohet se një raportim i tillë bazohet në të dhëna të pavërteta apo është bërë me qëllime tendencioze, ndaj tij mund të ndërmirren masa disiplinore.
7. ZRRE -ja ndalon hakmarrjen ndaj të punësuarve të cilët, me vullnet të mirë, kanë raportuar shkeljet e të tjerëve.



Neni 5

Përgjegjësitë e Kryesuesve të Departamenteve

1. Kryesuesit e Departamenteve në kuadër të përgjegjësisë të tyre si të punësuar duhet të mbajnë një ambient të punës që thekson përkushtimin për respektimin e këtij Kodi, rregullave, dhe ligjeve në fuqi.
2. Kryesuesi I departamentit gjatë kryerjes së detyrës duhet të ketë parim bazë korrektësisë, ndershmërisë, mirësjelljen, bashkëpunimin, solidaritetin, moralin e lartë në raport me personelin që ai udhëheq.
3. Në kryerjen e detyrave të tyre do të:
 - 3.1 Sigurojnë se anëtarët e personelit nën mbikëqyrjen e tyre do të marrin nga një kopje të Kodit, lexojnë dhe kuptojnë kërkesat e tij;
 - 3.2 Sigurojnë se anëtarët e personelit i kuptojnë detyrat e tyre afirmative për të raportuar shkeljet aktuale ose të dyshuara dhe procedurat e mekanizmat në dispozicion të tyre për të raportuar;
 - 3.3 Mbajnë një ambient të punës që parandalon hakmarrjen ose pasojat kundër anëtarit të personelit që me vullnet të mirë raporton shkeljet aktuale apo të dyshuara; dhe
 - 3.4 Raporton të gjitha shkeljet aktuale apo potenciale të rregullave në fuqi.

Neni 6

Obligimet e ish-anëtarëve të Bordit dhe ish anëtarëve të Personelit

1. Për një periudhë njëvjeçare pas mbarimit të mandatit si anëtar i Bordit, personit të tillë i ndalohe të paraqitet para bordit në emër të një ndërmarrjeje për energji të licencuar në bazë të këtij ligji, apo një subjekti që kontrollohet në mënyrë direkte apo indirekte nga një ndërmarrje e licencuar.
2. Ish-anëtari i Bordit dhe ish-anëtarët e personelit nuk do të zbulojnë çfarëdo informate që konsiderohet konfidenciale nga ZRRE-ja. Ata nuk do të abuzojnë apo shfrytëzojnë përparsinë për të keqpërdorur informatat konfidenciale, në të cilat kanë hasur gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare.

Neni 7

Konflikti i Interesave

1. Anëtari i Bordit dhe anëtari i personelit duhet ta kryej punën e tij me nder, me ndërgjegje si dhe në pajtim me dispozitat kushtetuese, ligjin dhe dispozitat tjera që përcaktojnë pozitën e tij si dhe të arsyetoj besimin e dhënë institucionit që e ka emëruar.



2. Asnjë anëtarë i Bordit dhe i personelit nuk duhet të lejoj që familja, marrëdhëniet shoqërore ose të tjera të ndikojnë në vlerësimet e tij profesionale. Asnjë anëtarë i Bordit apo i personelit nuk duhet të përdorë, ose të veprojë në mënyrë që të krijohet përshtypja e përdorimit të autoritetit dhe mundësitë që krijohen për shkak të pozitës e tij, për të avansuar interesat private të tij apo të tjerëve, dhe as nuk bën që të përcjellë ose lejoj të tjerëve që të krijojnë përshtypjen që në të mund të ndikohet në atë drejtim.
3. Për të menjanuar konfliktin e interesave, Kodi vendos ndalesat për anëtarët e Bordit dhe personelit si në vijim:
 - 3.1. Përveç rasteve të parapara në Nenin 16 paragrafi 2 dhe 3 i këtij Kodi, asnjë anëtarë i Bordit apo personelit nuk duhet të pranoj të mira financiare ose përfitime tjera, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga cilado ndërmarrje për energji degë apo filialë e një ndërmarrje të tillë, duke përfshirë por pa u kufizuar në to, paratë, mallin, patundshmërinë, dhuratat, udhëtimet, apo shërbimet personale, ashtu siç rregullohet me ligjet në fuqi.
 - 3.2. Asnjë anëtarë i Bordit apo personelit nuk duhet të ketë ndonjë interes, financiar ose tjetër, të drejtpërdrejt ose të tërthortë, ose të ushtroj ndonjë kontroll menaxherial mbi operimet e ndonjë ndërmarrje të energjisë të rregulluar nga ZRRE, ose ndonjë pasardhës, ose ndonjë subjekt të kontrolluar drejtëpërsëdrejti ose tërthorazi nga një ndërmarrje e tillë.
 - 3.3. Asnjë anëtar i Bordit apo personelit nuk mund të jetë i punësuar nga ndonjë ndërmarrje e energjisë njëkohësisht si konsulent ose Anëtarë i Bordit apo në ndonjë pozitë tjetër që mund të shpie në konflikt të interesit.
 - 3.4. Situatat e tjera ekzistuese ose të mundëshme që mund të shpiejnë në konflikt të interesit.
4. Konflikti i interesave mund të mos jetë gjithmonë i qartë dhe evident. Kur një anëtar i personelit ka dyshim nëse një aktivitet i caktuar përbënë konflikt interesi, për veten e tij ose të tjerëve, ai duhet të konsultohet me mbikqyrësin e tij.
5. Anëtari i personelit i cili njoftohet me konfliktin potencial ose konfliktin e interesit duhet që t'i tërheqet vërejtja nga mbikqyrësi i tij.
6. Nëse një anëtar i Bordit të ZRRE-së i cili kërkon sqarim në lidhje me, ose njoftohet me një konflikt potencial interesi, duhet të konsultohet me anëtarët e tjerë të Bordit.



Neni 8

Njoftimi i anëtarit të Bordit mbi pozitën menaxheriale apo drejtuese të mbajtur në një organizatë private

1. Sipas Kodit të etikës profesionale, nga anëtarët e Bordit kërkohet të:
 - 1.1 Njoftojnë Bordin me shkrim mbi pozitën menaxheriale apo drejtuese të mbajtur nga ai në një organizatë private dhe detyrat që i përkasin asaj pozite.
 - 1.2. Një anëtarë i Bordit mund të vazhdoj të shërbej në një pozitë menaxheriale nëse shumica e të gjithë anëtarëve tjerë vendosin pozitivisht, gjatë një takimi ku ai anëtarë nuk është i pranishëm, që pozita e tillë nuk paraqet konflikt material interesi me detyrat e anëtarit në fjalë - si dhe që nuk mbartin rrezikun e pengimit material të bartjes së plotë dhe të besueshme të këtyre.
 - 1.3 Të njoftoj me shkrim mbi interesat pronësore mbi të cilat ai anëtarë apo cilido anëtarë i familjes së tij/saj është titullar në një organizatë private nëse ZRRE ka marrëveshje apo kontrata biznesi, aktuale apo të parashikuara me atë organizat.
 - 1.4 Antëtari i Bordit nuk mund të ndjekë, as të marrë pjesë, e as të provojë të ndikojë në takimet, diskutimet, negociatat, vendimet apo propozim-vendimet që ndërlidhen në qfarëdo mënyre me raportet aktuale afariste apo të parashikuara të ZRRE-së, me organizatat private në të cilën ai anëtarë apo cilido anëtarë i familjes së tij/saj është titullar i interesave pronësore, në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë.

Neni 9

Informatat Konfidenciale

1. ZRRE do të përcaktoj konfidencialitetin e informatave sipas procedurës së përcaktuar në Rregullin për Informatat Konfidenciale.
2. ZRRE mban të drejtën që të zbuloj informatën konfidenciale nëse vlerëson se interesi i përgjithshëm është më i rëndësishëm se dëmi i krijuar nga zbulimi i tillë, në pajtim me Rregullin për Informatat Konfidenciale.
3. Kur ZRRE të vlerësoj informatat konfidenciale gjatë seancave, Bordi duhet të përcaktoj se a do të mbyllë ndonjë pjesë apo tërë seancën për publikun. Materiali nga seanca nuk do të publikohet në ueb-faqen zyrtare ose të zbulohet, përveç për shqyrtim juridik sipas kërkesës nga Gjykata kompetente.
4. Anëtarët e personelit të cilët kanë qasje në informatat konfidenciale në asnjë kohë gjatë ose pas punësimit në ZRRE nuk mund të zbulojnë, përdorin ose shpërndajnë atë informatë për qëllim tregëtie ose për ndonjë qëllim tjetër, përveç për të kryer aktivitetet e tyre për ZRRE.



5. Përdorimi i informative të tilla për përfitime financiare personale, ose për të ju sjellur përfitime të tjerëve, nuk është vetëm për tu konsideruar si shkelje serioze e obligimeve të kontratës por mund të rezultoj në iniciimin e procedurave civile ose penale.

Neni 10

Sjellja ndaj Konsumatorit, Ndërmarrjes së Energjisë dhe Palëve tjera

1. Secili anëtarë i personelit duhet t'i respektoj detyrat dhe të veproj në mënyrë të paanëshme profesionale dhe në mënyrë të drejtë me konsumatorët, ndërmarrjet e energjisë, dhe palët e tjera gjatë përmbushjes së detyrave të tij.
2. Secili anëtar i personelit duhet të përmbush aktivitetin e tij me qëllim që të ngris, themeloj dhe mbroj parimet e objektivitetit, drejtësisë, paanësisë, transparencës, dhe jo-diskriminimit.
3. Ç'do anëtar i personelit, pavarësisht nga pozita e tij duhet të veprojë në mënyrë drejtë duke mos manipuluar, fshehur, keqpërdour informatat apo duke shtrembëruar faktet materiale, apo duke përdorur ndonjë praktike tjetër të padrejtë.

Neni 11

Mardhëniet me Investitorët

1. ZRRE është e përkushtuar, në pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe rregullative, në mbajtjen e një dialogu aktiv dhe të hapur me palët e interesuara, dhe investitorët.
2. Asnjë anëtar i personelit përveq atyre që janë të autorizuar nuk duhet të kontaktoj, ofroj të dhëna, informata, raporte ose përfaqësoj ZRRE-në para palëve të interesuara, investitorëve të mundëshëm ose investitorëve.

Neni 12

Komunikimi me Mediat

1. Përderisa komunikohet me media, anëtar i personelit duhet ti menjanoj referimit dhe pikëpamjet personale, dhe gjatë tërë kohës duhet të veproj në përputhje me dispozitat e vendosura në këtë Kod.
2. Në asnjë rrethanë nuk duhet që një anëtar i personelit të përdorë mediat për të mbrojtur interesat dhe ankesat e tij, për të zbuluar informatat e paautorizuara ose të përpiqet që të ndikoj në politikën vendimëmarrëse.
3. Anëtar i personelit i cili i kontaktohet nga mediat duhet të marrë aprovim nga mbikqyrësi i tij/kryesuesi i ZRRE-së para së të komunikoj në lidhje me aktivitetet e ZRRE-së.



Neni 13

Ambienti, Shëndeti dhe Siguria

1. ZRRE do të ushtroj veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi që ka të bëjë me ambientin, shëndetin dhe sigurinë në përgjithësi.
2. ZRRE do të siguroj që secili anëtar i personelit të ketë ambient të punës të sigurt dhe të shëndetëshëm dhe i gjithë legjislacioni i aplikueshëm që ka të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në punë të zbatohen nga ZRRE.
3. Secili anëtar i personelit ka përgjegjësi për të mbajtur vendin e punës të sigurt dhe shëndetëshëm për të gjithë punëtorët duke i respektuar rregullat dhe praktikat e sigurisë dhe shëndetit, duke raportuar aksidentet, lëndimet dhe paisjet praktikat dhe kushtet e pasigurta.

Neni 14

Përputhshmëria me Softuerin

1. Softueri kompjuterik, doracakët dhe materialet tjera të mbrojtura me të drejtën e autorit dhe të drejtën e pronësisë janë materiale të mbrojtura dhe nuk mund të riprodhohen për përdorim personal.
2. Softueri, qoftë i blerë nga shitësi ose i zhvilluar nga ZRRE, është i mbrojtur me të drejtën mbi kopjimin dhe poashtu mund të mbrohet përmes patentit ose sekretit tregtar, ose mund të konsiderohet informatë konfidenciale. Softueri i tillë përfshinë programet kompjuterike, bazën e shënimeve dhe dokumentacionin e ndërlidhur.
3. Dispozitat dhe kushtet e marrëveshjes për licencë, sikur që janë dispozitat për të mos kopjuar apo shpërndarë programet, duhet të zbatohen.

Neni 15

Mbrojtja dhe Përdorimi i Resurseve

1. Të gjithë anëtarët e personelit kërkohet që ti mbrojnë dhe me efikasitet të përdorin resurset e ZRRE-së, duke përfshirë përdorimin e Internetit, postës elektronike ose resurset tjera të sistemit informativ.
2. Çdo mashtrim apo vjedhje e dyshuar duhet të raportohet menjëherë për hetime.
3. Anëtarët e Bordit dhe personelit nuk lejohen të përdorin pajisjet zyrtare të ZRRE-së në kundërshtim me rregullativën përkatëse.
4. Si informata të mbrojtura do të jenë edhe: pronësia intelektuale e ZRRE-së, shënimet dhe informatat, sekretet e punës, patentet, produktet e mbrojtura, e drejtat e kopjimit, planet e biznesit, marketingut dhe shërbimit, bazat e shënimeve dhe çdo shënim dhe raport financiar të publikuar.



5. Përdorimi ose shpërndarja e paautorizuar e këtyre informatave sipas paragrafit 4 të këtij neni jo vetëm që paraqet shkelje të këtij Kodi por mund të rezultoj edhe me iniciimin e procedurës civile apo penale.
6. Anëtarët e Bordit apo personeli nuk kanë të drejtë të blejnë apo shesin asnjë mjet ose pronë të ZRRE –së, pa miratimin paraprak të Bordit. Në rast se Bordi e miraton një blerje ose shitje të tillë, duhet të aplikohet Ligji për prokurimin publik në Kosovë.

Neni 16

Pranimi i Dhuratave

1. Anëtarët e Bordit dhe personeli i ZRRE-së nuk lejohen të ofrojnë të mira materiale ose dhurata personale që kanë vlerë më të madhe se vlera modeste që mund të kuptohet si përpjekje për të ndikuar pahijshëm në vendimet ndërmarrjeve të licencuara apo palëve të treta.
2. Anëtarët e Bordit, personeli i ZRRE-së ose anëtarët e familjeve të tyre nuk u lejohet të kërkojnë ose pranojnë të mira materiale ose dhurata personale që kanë vlerë më të madhe se vlera modeste që mund të kuptohen si përpjekje për të ndikuar pahijshëm në vendimet e konsumatorit ndërmarrjeve të licencuara dhe palëve të treta.
3. Dhurata e rastit me vlerë të vogël konsiderohen dhuratat e dhëna në moment të caktuara, vlera e të cilave nuk e kalon shumën prej pesëdhjetë (50) euro, ose vlera e përgjithshme e tyre nuk e kalon vlerën njëqindë (100) euro në vit, nëse janë dhënë nga I njëjti person.
4. Anëtarët e Bordit dhe personeli i ZRRE-së nuk lejohet të pranojnë të holla të gatshme.
5. Anëtari i personelit duhet ta informojë me shkrim eprorin e tij, nëse i është ofruar ose dhënë një dhuratë pa paralajmërim dhe në rrethana specifike.
6. Kur anëtari i personelit dyshon, nëse mund apo jo të pranojë dhuratë, ai duhet ta marrë miratimin e eprorit të tij. Në rast se është anëtarë i bordit ai duhet ta marrë miratimin drejtpërdrejt nga Bordi i ZRRE-së.

Neni 17

Praktikat e Kontabilitetit

1. ZRRE publikon të dhënat financiare në pajtim me standardet dhe praktikat e aplikueshme ndërkombëtare të kontabilitetit, ligjet, rregullat dhe aktet nëligjore të aplikueshme në Kosovë.
2. Librat financiarë të ZRRE-së, shënimet, llogaritë dhe deklaratat financiare duhet të mirëmbahen në detaje të arsyeshme, të reflektojnë si duhet transaksionet e ZRRE, dhe duhet t'i përshtaten edhe kërkesave ligjore të aplikueshme edhe sistemit të brendshëm të kontrollit të ZRRE-së.



3. Zyrtari përgjegjës financiar i ZRRE-së apo anëtari i personelit që kryen funksione të ngjashme, do të përgatisin raporte të brendshme dhe të jashtme dhe deklarata financiare të plota, të sakta, me kohë dhe me të dhëna të kuptueshme bazuar në rregulloret, standardet e aplikueshme dhe praktikatat e qëndrueshme të veprimtarisë.
4. Është rreptësisht e ndaluar për anëtarët e Bordit dhe anëtarët e personelit të ZRRE-së, që të ndërmarrin çfarëdo veprimi ashtu që në mënyrë mashtruese të ndikoj, bind, manipuloj ose keqduhëzoj auditorin e jashtëm, me qëllim të paraqitjes së deklaratës financiare jo të saktë.

Neni 18

Ruajtja e Shënimeve

1. Të gjithë anëtarët e personelit derisa kryejnë aktivitetet e tyre do të sigurohen se të gjitha të hyrat dhe transaksionet e ndërlidhura me shënimet dhe sistemet e ZRRE-së, përfshirë informatat elektronike financiare dhe jo-financiare, të shënohen dhe raportohen plotësisht, saktësisht, me kohë dhe në mënyrë të kuptueshme në pajtim me standardet dhe ligjislacionin në fuqi.
2. Të gjitha shënimet do të ruhen dhe mbahen në departamentet përkatëse të ZRRE-së.

Neni 19

Aktivitetet Humanitare

1. ZRRE është e përkushtuar në mbajtjen e marrëdhënieve të mira me të gjitha organizatat humanitare që veprojnë brenda dhe jashtë Kosovës.
2. Anëtarët e personelit janë të inkurajuar që Bordit të ZRRE-së ti japin sugjerime për çështjet humanitare. Bordi do të vendos se cilat aktivitete humanitare mund ti përkrah.
3. Anëtarët e personelit duhet, në çdo kohë, ti shmangen konfliktit të interesit dhe nuk do të marrin pjesë në çfarëdo aktiviteti humnitar që mund të paraqes konflikt interesi.

Neni 20

Kontributet politike

1. Asnjë fond as mjet i ZRRE-së, nuk do t'i huazohet cilësdo parti politike apo organizate politike, ose cilitdo individ që mban ose është kandidat për post politik.
2. ZRRE është agjencion i pavarur rregullativ, dhe si e tillë, ajo nuk bën të inkurajoj çfarëdo ndikimi politik ose të angazhohet në aktivitete politike.
3. ZRRE nuk do të pranoj donacione nga të licencuarit, nga personat që drejtpërsëdrejti ose tërthorazi janë të kontrolluar nga të licencuarit, partitë politike, grupet e lobimit ose shoqatat e konsumatorëve.



Neni 21

Shkeljet

1. Shkeljet e dispozitave të këtij Kodi mund të rezultojnë me masa disiplinore, përfshirë por jo edhe kufizuar në vërejtje me gojë ose vërejtje me shkrim, suspendim dhe me ndërprerjen e kontratës, në pajtim me procedurat e vendosura në legjislacionin në fuqi.
2. Vendimi për shqiptimin e masave disiplinore do të merr parasysh: seriozitetin e shkeljes; historin e kaluar të individit, dhe rrethanat e çështjes në fjalë.
3. Një anëtar i personelit që bëhet i vetdijshëm për një veprim që është shkelje, ose që shpie në shkelje të këtij Kodi, ka të drejtë të denoncojë apo raportojë vetë nëpërmjet eprorit shkeljen e tillë. Një anëtarë i Bordit në situatë të tillë duhet që menjëherë të informojë anëtarët tjerë të Bordit të ZRRE-së.

Neni 22

Komunikimet

Ky Kod do ti komunikohet të gjithë anëtarëve të personelit (sipas Shtojcës së këtij Kodi), dhe do të publikohet në ueb-faqen zyrtare të ZRRE-së.

KREU II DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 23

Gjuha zyrtare

Ky kod është nxjerrë në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Neni 24

Ndryshimi

1. ZRRE mban të drejtën që të ndryshoj ose modifikoj çdo dispozitë të këtij kodi.
2. Procedurat për ndryshim ose modifikim të këtij kodi, do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 25

Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e këtij kodi, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 26

Shfuqizimi

Ky Kod shfuqizon Kodin e Sjelljes dhe Etikës i nxjerr në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.2004/9 dhe i miratuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë 15.12.2005.



Neni 27
Hyrja në fuqi

Kodi hyn në fuqi nga dita e aprovimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar



SHTOJCË: Deklaratë për pranim të këtij kodi.

DEKLARATË

Deklaroj që kam marrë dhe lexuar Kodin e Etikës Profesionale të ZRRE-së, e kam kuptuar dhe e kam parasysh se duhet t'i përmbahem këtij kodi, dhe se shkelja e dispozitave të tij ose kërkesave tjera ligjore, të zbatueshme ndaj punës sime mund të rezultojnë me masa disiplinore nga punëdhënësi.

Jam në dijeni se gjatë kohës sa jam i punësuar në ZRRE do të disponoj me informata konfidenciale sipas Rregullit mbi Informatat Konfidenciale. Jam në dijeni se këto informata janë pronë e ZRRE-së si dhe janë të një rëndësie të veçantë, kështu që nuk duhen të ofrohen apo përdorën jashtë ambientit të ZRRE-së apo të diskutohen me personat që nuk janë pjesë e ZRRE-së, përveç nëse në mënyrë të qartë lejohet nga mbikëqyrësi, apo nëse kërkohet me ligj.

Në rastin e ndërprerjes së punësimit nga çfarëdo baze, nëpërmjet kësaj deklarate unë pajtohem që në asnjë mënyrë të mos përdorë apo shfrytëzoj këto informata.

Emri i punëtorit: (të shkruhet me shkronja të shtypit)	
Titulli i punës:	
Departamenti:	
Nënshkrimi i Punëtorit:	
Data:	
Emri i punëtorit të Administratës:	
Nënshkrimi:	
Data:	

Të gjithë të punësuarit duhet të nënshkruajnë këtë formular me rastin e punësimit. Një kopje origjinale do të ruhet në dosje të të punësuarit në Departament të Administratës dhe një kopje do t'i ipet të punësuarit.

Mosnjohja e Statutit dhe Kodit të Etikës profesionale të ZRRE-së, nuk i arsyeton anëtarët e Bordit dhe personelin e ZRRE-së, për çfarëdo shkelje të dispozitave të tyre.